



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI - CORRUPTION AGENCY



Nr. Prot. Br. Prot. Prot No. 01-588/16
 Data Datum Date 12-02-2016
 Nr. pages 03

DATE/A:	12.02.2016
REFERENC-Ë:	AKK - DPKPP 03-03/4496/15
PËR/ZA/TO:	z. Arton BERISHA, Drejtore i Zyrës së Prokurimit në Ministrinë e Administratës Publike
CC:	z. Naser SHAMOLLI, u.d. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Administratës Publike
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Ndërtimi i Universitetit të Mitrovicës – faza II "

I nderuari z. Berisha ,

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nënpar. 1.1. dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nënpar. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nënpar. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin " Ndërtimi i Universitetit të Mitrovicës – faza II " me numër prokurimi 202-15-096-511, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me monitorimin e procesit rreth ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderëve lidhur me aktivitetin e prokurimit publik me titull " Ndërtimi i Universitetit të Mitrovicës – faza II " me numër prokurimi 202-15-096-511, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Ministria e Administratës Publike - MAP.

A r s y e t i m i

Agjencia kundër Korrupsionit me datë 30.11.2015, ka nxjerrë vendim me numër protokolli AKK-03-3-4496/15 për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull " *Ndërtimi i Universitetit të Mitrovicës – faza II* " me numër prokurimi 202-15-096-511, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Ministria e Administratës Publike - MAP.

Me datë 21.12.2015, Agjencia kundër Korrupsionit ka paraqitur njoftimin për pjesëmarrje në vëzhgim pranë Autoritetit Kontraktues të cilin e ka njoftuar se Agjencia do të merr pjesë në cilësinë e vëzhguesit në procesin rreth ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderëve. Agjencia pasi ka trajtuar dokumentet në dispozicion dhe ka marr pjesë në monitorimin rreth vlerësimit të tenderëve ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë Procedurën e hapur, kontratë të llojit Punë me vlerë të madhe të kontratës.

Për këtë aktivitet të prokurimit dosjen e tenderit e kanë tërhequr gjithsej 50 Operator ekonomik ndërsa ofertat për këtë kontratë i kanë dorëzuar 8 prej tyre.

Komisioni për ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve, pas vlerësimit të ofertave ka konstatuar se nga tetë ofertat e pranuar për këtë tender, dy prej tyre janë oferta të përgjegjshme në pajtim me të gjitha kërkesat e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, ndërsa gjashtë tjera nuk janë oferta të përgjegjshme, pasi që nuk janë në pajtim me të gjitha kërkesat e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit.

Gjatë monitorimit Agjencia kundër Korrupsionit ka vërejtur se në paramasën dhe parallogarinë për këtë projekt tek paramasa dhe parallogaria për Trafostacionin në FXM dhe FSHTA më saktësisht në pozicionin 1356 pika 1.8. *Porositja ,furnizimi transporti dhe shtrirja e rërës se imët me trashësi 10cm nën dhe 10cm mbi gypat PVC*, Autoriteti kontraktues ka paraparë njësinë matëse m3 por jo edhe sasinë e parashikuar për këtë pozicion. Lidhur me këtë të gjithë Operatorë ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit e kanë pranuar dosjen të bashkangjitur me paramasën dhe parallogarinë të njëjtë dhe asnjëri prej Operatorëve konkurrues nuk e ka plotësuar këtë pozicion.

Në lidhje me këtë çështje Agjencia kundër Korrupsionit ka mbajtur takim me përfaqësuesit e Autoritetit kontraktues për sqarimin e këtij pozicioni, më konkretisht AKK ka qenë e interesuar të dijë se në paramasën e kompanisë projektuese a është inkorporuar ky pozicion.

Agjencia kundër Korrupsionit, përmes Ministrisë së Administratës Publike ka pranuar sqarimin me shkrim nga Kompania e cila e ka përgatitur projektin si në vijim: *"Hapja e kanalit me dimensione 0.8x1.2m, për shtrirjen e gypave PVC, ngjeshja dhe mbulimi i kanalit pas shtrirjes së gypave dhe e rërës", sasia 350m.*" Ku ka sqaruar se tek pozicioni 1.7: Ky pozicion parasheh hapjen e kanalit për vendosjen e kablllove të tensionit të lartë siç është e përshkruar në pozicionin 1.7, dhe parasheh hapjen e kanalit me gjatësi 350m. Në këtë kanal duhet të vendosen katër gypa mbrojtës për katër kablllo energjetike nëntokësore të tensionit të mesëm, njëra kablllo është paraparë të mbetet rezervë sipas kushteve të përcaktuara nga KEK tash KEDS. Ndërsa tek pozicioni 1.9 *"Porositja, furnizimi, transporti dhe shtrirja e gypit PVC me diametër 160 mm për lidhjen e pushtave për kabllon 10kV", Sasia 1400m.*" Kompania projektuese ka dhënë sqarim se ky pozicion parasheh sasinë e gypave që duhet të vendosen në kanalin sipas pozicionit 1.7.

Në kanalin me gjatësi prej 350m duhet të vendosen katër (4) gypa mbrojtës sipas përshkrimit në pos.1.7, gypat mbrojtës përdoren për vendosjen e katër kablllove energjetike nëntokësore të tensionit të mesëm 10kV, XHE / 48 1X159mm².

Pasi kabllot energjetike nëntokësore të tensionit të mesëm janë kablllo një fijore XHE 1X150mm², janë paraparë katër gypa mbrojtës për vendosjen e secilës kablllo.

Pra në kanalin me gjatësi prej 350m janë paraparë nga katër (4) gypa mbrojtës të kablllove energjetike nëntokësore të tensionit të mesëm për çdo metër gjatësi. Sasia e gypave do të jetë: $350 \times 4 = 1400$ m gyp mbrojtës.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka analizuar sqarimin e Autoritetit kontraktues të dhënë nga Kompania projektuese e ka kuptuar se pozicioni 1.8 ku mungon sasia është i inkorporuar në pozicionin 1.7.

Agjencia Kundër Korrupsionit konsideron se ekzaminimi, krahasimi dhe vlerësimi i ofertave është kryer në mënyrë profesionale dhe në pajtim me dispozitat e LPP-së dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të procedojë me këtë aktivitet të prokurimit konform Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik .

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Me respekt !